



#65769601

SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET

UDHËZUES PËR PRINDËR
DHE EDUKATORË



An EU funded project managed by
the European Union Office in Kosovo



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosovo Education Center

KEC

SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET

UDHËZUES PËR PRINDËR
DHE EDUKATORË

Siguria e Fëmijëve në Internet **Udhëzues për prindër dhe edukatorë**

Autorët:

Teuta Zymeri

Besianë Musmurati

Qendra për studime të avancuara – FIT

Editorë:

Kushtrim Bajrami

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

Dizajni, faqosja dhe shtypja:

Envinion

Botuar nga:

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

Ky dokument u hartua në kuadër të projektit "Mbrojtja e fëmijëve nga rreziqet në internet - PROCON" që financohet nga Komisioni Evropian, Zyra në Kosovë. Projekti zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me Këshillin Rinor Kosovar (KYC) dhe International Children Safety Service (ICSS) dhe në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZKM/ZQM). Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e organizatave zbatuese dhe në asnjë rrethanë nuk i atribuohet donatorit.

PARATHËNIE

Udhëzuesi për Prindër dhe Edukatorë ofron këshilla për prindër dhe edukatorë rreth sigurisë së fëmijëve në internet. Ky botim është përgatitur nën përgjegjësinë e përbashkët nga dy organizata joqeveritare: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) dhe Qendra për Studime të Avancuara (FIT). Përgatitja e Udhëzuesit është e bazuar në përvojën disavjeçare të dy organizatave në fushën e sigurisë së fëmijëve në internet si dhe në konsultime të vazhdueshme të bëra me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm të kësaj lëmie.

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative në vitet e fundit i asociuar edhe me rritjen e nivelit të rreziqeve të shfaqura si rrjedhojë e kyçjes jo të sigurt të fëmijëve në internet, në shumë vende të botës ka nxjerrë në pah rëndësinë e masave të që duhet të merren me qëllim që të mbrohen fëmijët në internet. Në këtë kontekst, fokusi i këtij Udhëzuesi është të ofroj rekomandime kyçe për prindërit dhe edukatorët në mënyrë që ata të sigurojnë internet sa më të sigurt për fëmijët tanë. Ky Udhëzues mund të shërbej si një burim i rëndësishëm reference për prindërit dhe edukatorët dhe ne rekomandojmë aplikimin e rekomandimeve të ofruara përmes këtij udhëzuesi në rastet kur fëmijët qasen në internet.

Konceptet e paraqitura në këtë Udhëzues janë të harmonizuara edhe me udhëzues të përgatitur nga vendet e Bashkimit Evropian të cilat janë anëtare të një rrjeti të quajtur “EU Kids Online Network”.

Kushtrim Bajrami

Menaxher i Projektit PROCON

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	3
Qasja e fëmijëve në internet	8
Për çfarë e përdorin fëmijët internetin?	10
Çka nuk dinë shumica e prindërve dhe edukatorëve për monitorimin e fëmijëve online?.....	13
Si të shikoni historinë e klikimeve në internet?	15
Si t'i bllokoni reklamat gjatë përdorimit të internetit?	16
Si të instaloni kërkimin e sigurt?.....	16
Aktivitetet online dhe pasojat	17
Rrjetet Sociale.....	18
Rreziqet potenciale nga përdorimi i internetit	21
Sajbërdhuna	22
Takimi me njerëz të panjohur	26
Ekspozimi ndaj përmbajtjes pornografike.....	29
Pasionimi pas video-lojërave.....	33
Publikimi dhe keqpërdorimi i të dhënave personale	36
Këshilla të përgjithshme për prindër	41
Konkluzione	47

HYRJE

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ndihmojë prindërit dhe edukatorët të kenë rol sa më aktiv dhe mbështetës për të siguruar që fëmijët janë të vetëdijshëm për rreziqet që ju shfaqen gjatë përdorimit të internetit. Publikimi i Udhëzuesit për Fëmijë është rezultat i punës disa mujore të Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC) dhe Qendrës për studime të avancuara (FIT) dhe në bashkëpunim me ekspertë të ndryshëm vendor e ndërkombëtarë të kësaj fushe. Udhëzuesi është azhurnim i botimit të parë të publikuar në vitin 2012. Kjo iniciativë është mbështetur financiarisht nga Komisioni Evropian në Kosovë në kuadër të projektit “Mbrojtja e Fëmijëve nga Rreziqet në Internet - PROCON”. Mendimet, përfundimet, konkludimet apo rekomandimet e shprehura në këtë dokument këtu janë të Qendrës KEC dhe Qendrës FIT dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Komisionit Evropian.

Interneti ka ndikuar shumë në ndryshimin e mënyrës së jetesës sonë, veçanërisht të fëmijëve tanë. Ky fenomen është një botë në vete që bart shumë gjëra dhe mundësi të mira për të mësuar gjëra të reja, komunikuar me njëri tjetrin, apo për t’u argëtuar, por gjithashtu interneti përmban edhe rreziqe të cilat mund të ndikojnë keq në jetën e fëmijëve. Për shumë prindër dhe edukatorë, interneti mund të jetë një sfidë për shkak të njohurive të limituara rreth përdorimit të tij. Mbrojtja e fëmijëve në internet

bëhet më e vështirë atëherë kur vetë fëmija është më i informuar për internetin sesa prindërit apo edukatorët.

Kur fëmijët janë online, ata mund të kenë komunikim të drejtpërdrejtë me shokë/shoqe, familjarë dhe gjithashtu me njerëz të huaj. Është përgjegjësi e secilit të rritur që t’i ndihmojë fëmijët të mësojnë për sigurinë e tyre në internet. Kjo përfshin prindërit, mësuesit, edukatorët, kujdestarët, apo këdo tjetër që në një mënyrë kujdeset për fëmijët.

Edukimi i fëmijëve rreth internetit të sigurt mund të jetë i vështirë, sidomos në këtë kohë kur teknologjia avancon shumë shpejtë. Përveç prindërve që duhet të jenë shumë të kujdesshëm, edhe edukatorët apo mësuesit në shkolla luajnë një rol kyç në edukimin e fëmijëve rreth internetit të sigurt. Shqetësimet kryesore të edukatorëve janë mbikëqyrja e nxënësve gjatë përdorimit të internetit në shkollë si dhe ofrimi i ndihmës në rast se fëmijët i ekspozohen ndonjë rreziku. Është e rëndësishme që edukatorët të kenë qasje pozitive dhe të bashkëpunojnë me prindërit në edukimin e fëmijëve për mënyrat e qasjes në internet si dhe nga rreziqet që mund t’u kanosen. Sfidë për prindërit është mbetja në hap me teknologjitë që fëmijët e tyre përdorin si dhe mënyrat e mbrojtjes së fëmijëve në internet.

Ky udhëzues ka për qëllim që t'ua bëjë më të lehtë atë se çfarë duhet të bëni ju si prindër apo edukatorë në mënyrë që fëmijët tuaj të jenë të sigurt kur përdorin internetin. Këtu, ju do të gjeni këshilla dhe udhëzime praktike se si të veproni në raste të përballjes me rreziqe të ndryshme si sajberdhuna, takimi me njerëz të panjohur, ekspozimi ndaj përmbajtjes pornografike, lojërat online, si dhe keqpërdorimi i të dhënave personale.

Objektivat kryesorë të këtij Udhëzuesi janë:

- të informojë prindërit dhe edukatorët se për çfarë fëmijët e përdorin internetin dhe cilat janë rreziqet potenciale gjatë përdorimit të internetit;

- të këshilloj prindërit dhe edukatorët se çfarë mund të bëjnë ata për t'i mbrojnë fëmijët nga rreziqet e ndryshme dhe si t'i ndihmojnë ata të përballen me rreziqe të tilla.

Ne rekomandojmë përdorimin e këtij Udhëzuesi nga prindërit, edukatorët dhe të rriturit të tjerë që përkujdesen për fëmijë si dhe t'i inkurajojë ata që të përdorin këtë material për të kuptuar sadopak kompleksitetin e shfrytëzimit e sigurt të internetit nga fëmijët, dhe që të përdorin këto udhëzime bazike për të mbrojtur fëmijët e tyre në internet.

NDRYSHIMET KRYESORE TË INKORPORUAR NË BOTIMIN E DYTË

Për dallim nga versioni i parë i udhëzuesit, ky version është më i azhurnuar sa i përket statistikave rreth përdorimit të internetit nga fëmijët Kosovar. Struktura e shpjegimit të materialit mbetet e njëjtë, por janë ofruar informata shtesë për shumë rreziqe të cilat nuk janë adresuar në udhëzuesin e kaluar.

Një tjetër dallim shumë i rëndësishëm është edhe rritja e volumit të gjithë kapitujve të udhëzuesit. Janë shtuar pjesë në secilin kapitull si dhe janë ndryshuar shumë pjesë për të qenë më në kohë me zhvillimet e fundit të teknologjisë. Ky Udhëzues merr për bazë

zhvillimet e shpejta të teknologjisë, për shembull, integrimin e rrjeteve sociale në telefona të mençur, përhapjen e wireless-it dhe çështjet që kanë të bëjnë me sjelljet e fëmijëve në ditët e sotme.

Ky version i udhëzuesit përmban më shumë ilustrime në mënyrë që të paraqiten problemet në mënyrë grafike dhe këshillat të jenë sa më lehtë të kuptueshme nga prindërit dhe edukatorët. Gjithashtu, ky version do të ketë rekomandime edhe për edukatorët ndërsa i kaluari ka qenë vetëm për prindër.

QASJA E FËMIJËVE NË INTERNET

Sot interneti është bërë pjesë e ambientit të jetës së fëmijëve, prandaj që nga mosha e re, shumica e fëmijëve kanë qasje në internet nga shumë vende dhe nga shumë pajisje. Zhvillimet teknologjike i mundësojnë fëmijëve që të kenë qasje 24 orë në internet, gjë që mund të sjellë rreziqe të ndryshme për fëmijët. Gjithsesi, mënyrat e mënjanimit të rreziqeve varen shumë nga vendi dhe pajisja prej nga fëmijët kanë qasje në internet.

Në raportin Siguria e fëmijëve në Internet të përgatitur nga Qendra FIT dhe Save the Children në vitin 2014, ku të dhënat janë marrë nga një anketë me 1150 fëmijë nga komunat më të mëdha të Kosovës, ka rezultuar që 93% e tyre e përdorin internetin, ndërsa 45% e tyre kalojnë më shumë se një orë në ditë online.

Prandaj në ambientin e tanishëm ku teknologjia po dominon çdo ditë e me shumë dhe e cila ofron



shumë opsione në dispozicion, fëmijët shumë lehtë mund të kyçen në internet. Kjo është arsyeja pse prindërit dhe edukatorët duhet t'i përgatisin fëmijët për sigurinë në internet. Fëmijët që janë të përgatitur dhe të vetëdijësuar për sigurinë në internet, janë më pak të rrezikuar gjatë përdorimit të internetit. Është shumë e rëndësishme që të dallohen vendet e qasjes të fëmijëve në internet sepse varësisht nga vendi i qasjes dallon edhe mënyra e adresimit të rreziqeve. Vendet prej nga ku fëmijët kanë qasje në internet janë:

Shtëpia - shumë shtëpi tani kanë kompjuter personal apo ndonjë laptop me qasje në internet.

Shkolla - shumica e shkollave kanë kabinete të kompjuterëve prej nga fëmijët mund të qasen në internet. Poashtu shumica e shkollave kanë wi-fi dhe kjo u mundëson fëmijëve kyçje në internet nga pajisjet e tyre personale.

Miqtë - edhe nëse fëmijët tuaj nuk kanë qasje në internet nga shtëpia, është e mundshme që fëmijët mund të përdorin kompjuterin e miqve të tyre për t'u qasur në internet.

Internet Cafe - janë ambiente publike për qasje dhe përdorim të internetit, përkundër një pagese që duhet të behet për kohën që shfrytëzohet interneti.

Zona publike - fëmijët mund të kenë qasje të lirë në Wireless të ofruar nga kafiteri, apo zona të tjera publike.

Përpos vendit të qasjes në internet dallon edhe mënyra apo pajisja që fëmijët përdorin për tu lidhur me internet. Disa prej pajisjeve më të shpeshta që fëmijët përdorin për t'u kyçur në internet janë:

Kompjuteri (PC) - shumë shtëpi dhe shkolla tani kanë kompjuter ku qasja në internet është e mundur.

Laptopi ose tabletat e ndryshëm (iPad, Kindle, Nook) - çdo ditë e më shumë fëmijët po përdorin laptop apo tableta të ndryshme për t'u lidhur në internet,

Telefonat e mençur -përmes telefonave të mençur fëmijët mund të kyçen në internet. Gjithashtu gati të gjithë operatorët që ofrojnë shërbime të telefonisë mobile tani ofrojnë edhe shërbimet e internetit nëpërmjet telefonit mobil.

Pajisjet për lojëra (Nintendo Wii, PlayStation 3, Xbox 360) - shpeshherë prindërit apo edukatorët e fëmijëve mund të mos jenë të vetëdijshëm që qasja në internet është e mundur edhe përmes pajisjeve për lojëra.

Për çfarë e përdorin fëmijët internetin?

Për çfarë e përdorin fëmijët internetin?

Interneti ofron mundësi shumë të mira për fëmijët për të mësuar gjëra të reja që lidhen me interesat e tyre të përgjithshme, hobit, apo detyrat shkollore. Gjithashtu, interneti mund të përdoret për argëtim si për të dëgjuar muzikë, për të luajtur lojëra, shikuar filma, apo për të komunikuar me të tjerët. Sidoqoftë, grup moshë të ndryshme përdorin internetin në mënyra të ndryshme dhe për arsye të ndryshme. Më poshtë kemi paraqitur aktivitetet kryesore në internet sipas grupmoshave si në vijim:

Mosha 2- 6 vjet

Parashkollorët janë mjaft të rritur për të filluar eksplorimin në internet dhe të mësojnë në lidhje me botën digjitale. Fëmijët që nga mosha pesë vjeçare mund të fillojnë të vizitojnë faqet e internetit për fëmijë por ata gjithmonë do të duhet të jenë të shoqëruar nga prindërit. Preferohet që fëmijët e kësaj moshe të kalojnë sa më shumë kohë me moshatarët e tyre dhe larg nga ekranet digjitale.





Gjithsesi shumë prind mund të gjejnë përmbajtje interesante që mund të zgjojnë kureshtjen e fëmijëve të tyre. Video të ndryshme në Youtube mund të ju shërbejnë prindërve për të ju mësuar fëmijëve këngë apo për t'i argëtuar ata. Prindërit duhet të kenë kujdes që fëmijët në këtë moshë të mos e asociojnë argëtimin vetëm me përdorim të telefonit apo kompjuterit por të zhvillojnë lojëra interaktive në mënyrë që fëmija të zhvillohet sa më shëndetshëm.

Mosha 7-11 vjet

Kjo grup moshë është më problematike për t'u menaxhuar për shkak që fëmijët janë mjaft të vetëdijshëm për përdorimin e internetit dhe mundësitë që ofron por nuk janë të vetëdijshëm për rreziqet online. Gjithashtu fëmijët e kësaj grupmoshe e kanë më të vështirë t'i kuptojnë rreziqet edhe nëse prindërit apo edukatorët ju shpjegojnë ato.

Disa fëmijë në këtë moshë mund të fillojnë të përdorin pavarësinë e tyre për të kërkuar në internet materiale të papërshtatshme për moshën e tyre. Reklammat e ndryshme në internet mund të synojnë këtë moshë, por kjo moshë, gjithnjë e më shumë, mësojnë të njohin dallimin në mes reklamimit dhe materialeve të tjera. Kjo ndihmon për të folur me fëmijët rreth reklamave, rrjeteve sociale, etj. dhe mënyrave se si duhet të merren me to. Aftësitë dhe pavarësia e tyre do të vazhdojnë të rriten, por duke bërë hulumtimin në internet si një aktivitet i përbashkët familjar, u mundëson prindërve për të ruajtur dhe mbikëqyr nga afër fëmijët e tyre.



Mosha 12-16 vjet

Në këtë moshë për adoleshentët interneti bëhet një mjet i rëndësishëm në jetën e tyre. Tanimë ata fillojnë të përdorin internetin për të hulumtuar për detyrat e shtëpisë dhe projektet e ndryshme. Në të njëjtën kohë, adoleshentët e rinj fillojnë të bëhen më të pavarur dhe kanë më shumë vetëbesim, si dhe gjithnjë e më shumë duan liri. Shumica e fëmijëve në këtë moshë veçse e kanë krijuar profilin e tyre në internet përmes rrjeteve sociale dhe shkëmbimi i emailave rritet.



Disa mund të kundërshtojnë përdorimin e programeve për filtrim dhe bëjnë përpjekje për të hyrë në faqe të internetit që kanë material të papërshtatshëm. Shumë adoleshentë më të rritur mund të fillojnë të krijojnë programet e tyre dhe dinë se si të menaxhojnë pajisjet digjitale shumë më mirë sesa vetë prindërit apo edukatorët. Këto shkathtësi dhe njohuri të tyre mund të ju sjellin telashe nëse ata nuk janë të informuar për rreziqet që mund të shfaqen në internet. Kjo moshë më së miri duhet të qaset përmes komunikimit direkt, qoftë ai në shtëpi apo në shkollë. Fëmijët në këtë moshë kanë më shumë tendencë që të kundërshtojnë prezencën e të rriturit gjatë përdorimit të internetit, prandaj rekomandohet që informimi për rreziqet online të bëhet pjesë e diskutimeve të shpeshta në familje apo klasë. Kjo është mënyrë e mirë që stimulon vetë fëmijët që ta diskutojnë këtë temë edhe me shoqërinë e tyre.

Çka nuk dinë shumica e prindërve dhe edukatorëve për monitorimin e fëmijëve online?

Ka disa mënyra se si prindërit apo edukatorët mund të bllokojnë qasjen e fëmijëve nëpër uebfaqe të nuk janë të përshtatshme për fëmijë. Prindërit mund të instalojnë programe të cilat e bllokojnë automatikisht qasjen në uebfaqe të ndryshme pornografike, lojëra bixhozi, apo përmbajtjeve të dhunshme.

Si prindër apo edukatorë mund të jetë e vështirë të monitoroni se çka bëjnë fëmijët online. Shumica e prindërve i besojnë fëmijëve të tyre por fëmijët

sidoqoftë mund të ndeshin material shqetësues. Filtrimi dhe moderimi janë mënyra të mira për të ndaluar përmbajtjen e papërshtatshme dhe të dëmshme. Këto janë vegla që ju mundësojnë të vendosni kufij online sipas moshës së fëmijëve. Disa nga këto vegla janë falas dhe ka tjera që mund t'i bleni. Përdorni veglat që ju përshtaten nevojave të familjes suaj. Ne rekomandojmë që përpos në shtëpi, këto opsione për bllokimin e qasjes në uebfaqe të rrezikshme të bëhet edhe në shkolla.



Ka tri nivele kryesore për përdorimin e kontrolleve prindërore:

- **Internet Service Providers (ISP's):** Këto janë kompanitë që ju ofrojnë internet në shtëpinë tuaj. Shumica e IPS kompanive ofrojnë edhe kontrolle prindërore. Këto ju lejojnë të përdorni kontrolle në kompjuter apo mjete tjera me të cilat i qaseni Internetit.
- **Mjetet me të cilat shfrytëzoni Internetin:** Shumica e kompjuterëve, telefonave celularë, dhe pajisjeve të lojërave kanë edhe opsionin për kontroll prindëror. Për shembull sistemet operative Windows dhe Mac kanë opsionin

e kontrolleve që mund të aktivizohen në kompjuter.

- **Softveri:** Ka një mori paketash që mund të blihen apo shkarkohen nga Interneti falas për këtë qëllim.

Kontrollet prindërore nuk mund të bëjnë Internetin 100% të sigurt dhe ju duhet po ashtu të bisedoni me fëmijët tuaj për përdorimin e sigurt të Internetit.

Çdo paketë/veçël për kontroll prindëror duhet të përmbajë këto shërbime:

- Filtrim të përmbajtjes për të ndaluar qasjen në faqe të caktuara siç janë faqet pornografike;
- Kufizimet kohore për të kufizuar kohën gjatë së cilës fëmijët mund të përdorin internetin apo periudha kohore gjatë së cilave fëmijët mund të kenë qasje në faqe të caktuara;
- Monitorimi që ju informon rreth faqeve të cilat fëmijët e juaj tentojnë t'i vizitojnë;
- Raportimi që ju jep informata rreth faqeve që fëmija i juaj i ka vizituar.



Si të shikoni historinë e klikimeve në internet?

Ne besojmë që mënyra më e mirë për të mbrojtur fëmijën gjatë përdorimit të internetit është vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i fëmijëve përmes bisedave me prindër apo edukatorë. Gjithsesi, edhe monitorimi i vazhdueshëm besojmë që mund të jetë mundësi e mirë për të qenë gjithmonë në rrjedha me klikimet e fëmijëve tuaj.

Shpesh ndodh që fëmija nuk është i vetëdijshëm për rreziqet që i kanosen në internet dhe mund të mos e ndajë përvojën në internet me asnjë njeri tjetër, edhe pse kjo mund të i shfaq ndonjë rrezik. Prandaj, ju si prindër apo edukatorë shumë lehtë mund të shikoni gjithë historinë e klikimeve të fëmijës.



SI T'I BLOKONI REKLAMAT GJATË PËRDORIMIT TË INTERNETIT?



reklamave që mund të stimulojnë ata të hapin uebfaqe të rrezikshme apo të japin fjalëkalimet e tyre. Ka shumë mekanizma që prindërit dhe edukatorët mund të përdorin për të bllokuar reklamën përmes të cilave kompjuteri mund të sulmohet nga virus të ndryshëm.

Një mënyrë shumë e mirë është edhe instalimi i Adblock Plus, një program i besueshëm që bllokon reklamën e dyshimta gjatë përdorimit të internetit.

Përpos uebfaqeve jo të përshtatshme, ju duhet të siguroheni që fëmijët tuaj nuk ju ekspozohen

SI TË INSTALONI KËRKIMIN E SIGURT?

Secila pajisje që përdorni për t'u kyçur në internet duhet të ketë një opsion për të instaluar kontrollin prindëror. Por përpos pajisjeve, këtë shërbim e ofron edhe Google, njëra ndër uebfaqet më të popullarizuara të kërkimit. Më poshtë mund të shikoni se si mund të instaloni "Safe Search" apo në shqip Kërkimin e Sigurt.

Për të ndezur Google SafeSearch, klikoni ikonën e parametrave në anën e djathtë dhe pastaj klikoni "Turn on SafeSearch".



Aktivitetet online dhe pasojat

Shumë hulumtime të bëra kanë konfirmuar që fëmijët që e përdorin internetin për kohë më të gjatë mund të mësojnë më shumë, por gjithashtu edhe janë më shumë të rrezikuar. Për këtë arsye është shumë me rëndësi që ju të keni njohuri mbi aktivitetet e fëmijëve në internet. Përderisa prindërit apo edukatorët përdorin internetin për arsye akademike apo punë, fëmijët më shumë e përdorin internetin për të komunikuar me njëri tjetrin dhe për t'u argëtuar.

Sipas anketës së mëparshme me fëmijë, ka rezultuar që fëmijët kosovar më së shumti e përdorin internetin për t'u argëtuar (p.sh. për të dëgjuar muzikë 70.5%) dhe për të komunikuar

më njëri tjetrin (Facebook 74.2%). Rrjetet sociale përbëjnë një ndër aktivitetet më të preferuara të fëmijëve, përderisa kërkimi në internet për gjëra të ndryshme akademike nuk është shumë i popullarizuar.

Vlen të theksohet që përdorimi i internetit për çështje akademike apo profesionale paraqet shumë më pak rrezik për fëmijët sesa përdorimi për komunikim. Për këtë arsye, sa më i madh të jetë përdorimi i internetit për komunikim (Facebook, Twitter, Instagram) ose argëtim (dëgjimi i muzikës, lojërat, apo shikimi i videove në Youtube), aq më i madh është ekspozimi i fëmijëve ndaj rreziqeve të ndryshme.



Rrjetet Sociale

Me zhvillimin e madh teknologjik, popullariteti i rrjeteve sociale veç sa shkon dhe rritet, sidomos tek fëmijët. Sot rrjetet sociale përbëjnë një pjesë shumë të madhe dhe të rëndësishme të jetës së fëmijëve. Rrjetet sociale më të popullarizuara janë Facebook, Twitter, Instagram, MySpace, Hi5, LinkedIn, Flickr, Snapchat, Tumblr dhe MSN. Përpos kontaktit dhe personalitet që fëmijët e zhvillojnë në jetën e përditshme, fëmijët krijojnë edhe një profil digjital të tyre nëpër rrjete sociale,

që jo gjithmonë është i njëjtë me atë që prindërit apo edukatorët e njohin.

Me siguri shpesh keni dëgjuar për kritikën e të rriturve për varësinë e tyre në rrjete sociale dhe ankesat e shumta për kohën që ata shpenzojnë në këto rrjete. Një dallim shumë i madh mes të rriturve dhe fëmijëve në këtë aspekt është që të rriturit kanë më shumë sens për kohën dhe mund të dallojnë shumë lehtë që shpenzojnë më shumë kohë sesa që duhet në rrjete sociale.



Por fëmijët nuk janë në gjendje të kontrollojnë kohën që shpenzojnë online. Për këtë arsye ju duhet të kalkulonit se sa kohë shpenzojnë fëmijët tuaj nëpër rrjete sociale.

Çdo ditë e më shumë, rrjetet sociale po bëhen më të përsosura sa i përket shkëmbimit të informatave online. Integrimi i këtyre rrjeteve me telefon të mençur e ka bërë më të lehtë edhe shkëmbimin e fotove, videove, mesazheve me zë, adresave etj. Edhe pse kjo rritje komunikimi ofron shumë përparësi, nëse keqpërdoret mund të jetë një eksperiencë shumë e keqe për fëmijën. Në momentin që një postim është online (me dëshirë apo jo) në një prej rrjeteve sociale, postimi mund të bëhet viral dhe shumë njerëz do të mund të shohin atë brenda një kohe shumë të shkurtë. Për këtë arsye ju duhet të jeni shumë të kujdesshëm me atë se çka fëmijët postojnë online. Më poshtë keni disa pika që ju duhet të shqyrtoni me fëmijët në lidhje me profilet e tyre në rrjete sociale.



1. Plotësimi i të dhënave personale – Duhet të informoni fëmijën që të dhënat e tyre personale (emri, numri i telefonit, adresa, emri i shkollës, emri i prindit, etj) që ata i bëjnë publike nëpër rrjete sociale mund të

keqpërdoren shumë lehtë. Fëmijët mund të ngacmohen apo lëndohen duke bërë publike informata që nuk duhet bërë publike, sidomos adresa apo numri i telefonit.



2. Postimi në rrjete sociale – Vetëm Facebook i ka më shumë se 1 miliard përdorues aktiv të këtij rrjeti. Kjo statistikë tregon që

fëmijët duhet të kenë kujdes kur postojnë gjëra në këto rrjete pasi që ato mund të keqpërdoren nga shumë përdorues. Sipas postimeve që fëmijët bëjnë, ata zbulojnë se cilat janë interesat e tyre, apo cilat janë mendimet e tyre për tema të ndryshme. Ju duhet të jeni të vetëdijshëm që persona të rrezikshëm mund të përdorin këto tema që të joshin fëmijën për të komunikuar me ta dhe për të keqpërdorur ata në mënyra të ndryshme. Gjithashtu ne rekomandojmë që fëmijët të postojnë sa më pak foto në këto rrjete pasi që fotot janë mënyra më e lehtë për t'u keqpërdorur. Pas postimit të fotografive në internet, përveç se ju mundësohet të tjerave shikimi i fotografive të fëmijës tuaj, me këto foto mund të manipulohen, p.sh. duke vënë fytyrën e fëmijës tuaj në një trup tjetër, dhe kjo fotografi mund të përhapet në internet,

ose fëmija juaj mund të shantazhohet për të dërguar më shumë fotografi. Fëmijët gjithashtu tregojnë se ku gjinden përmes check-in në rrjetet sociale, ku tregohet vendi dhe ora e saktë se ku fëmija gjendet.



3. Shkarkimi i fotove, filmave, muzikës nga burime të panjohura –

Ky aktivitet është i rrezikshëm sepse shkarkimi nga burime të panjohura mund të ketë viruse të fshehura, të cilat mund të shkatërrojnë të gjitha të dhënat në kompjuterin tuaj. Gjithashtu ka virus të cilët mundësojnë keqbërësit të identifikojnë vendin se prej nga fëmija po e përdor internetin apo të dërgojnë gjurmues tjerë që mund të përdoren për të vjedhur identitetin e fëmijës tuaj, apo për të kërkuar pagesa të ndryshme për t'u kyçur.

4. Komunikimi online me të panjohur (përmes chat-it) –

Për shkak që komunikimi në internet nuk është ballë për ballë është shumë e lehtë të gënjejhet apo mashtrohet online. Bisedat e thjeshta mund të kenë motive të fshehta dhe shumë të dëmshme për fëmijën tuaj. Për shkak të moshës së tyre, fëmijët mund të mashtrohen lehtë në këto

platforma komunikimi dhe është mirë që ata të konsultohen herë pas here se me kë bisedojnë në këto rrjete.



5. Klikimi i njoftimeve apo reklamave që shfaqen –

Sikurse me shkarkimin e përmbajtjeve nga burime të panjohura, ashtu edhe me klikimin e njoftimeve apo reklamave mund të rrezikohet siguria e fëmijëve online. Përmes klikimit të njoftimeve fëmijëve mund të ju reklamohen produkte të cilat nuk janë të përshtatshme për moshën e tyre, apo të kërkojnë informata nga kartelat e kreditit në mënyrë që fëmija të bëjë ndonjë blerje. Kjo është shumë e rrezikshme sepse përpos natyrës psikologjike mund të ketë edhe dëme financiare. Gjithashtu njoftime të ndryshme përmbajnë virus që mund të vjedhin fjalëkalimin e fëmijës apo të postojnë në emër të tyre.



Rreziqet potenciale nga përdorimi i internetit

Njohja me rreziqet potenciale dhe inkurajimi i përdorimit të sigurt të internetit janë hapa esencial në drejtim të menaxhimit të rrezikut për të mbajtur fëmijët tanë të sigurt kur kyçen në internet. Teknologjia është duke u zhvilluar me një ritëm të shpejtë. Zhvillimi i teknologjisë paraqet një sfidë për gjithë shoqërinë, e posaçërisht për fëmijët dhe të rinjtë të cilët duhet të jenë të aftësuar për përdorimin e kësaj teknologjie. Rritja e mundësive të mëdha për t'u kyçur në internet nga pajisje dhe vende të ndryshme rrit edhe rreziqet nga përdorimi i internetit. Prandaj sa më shumë që

fëmijët fillojnë të përdorin internetin dhe pajisjet e teknologjisë informative, ata duhet edhe të rrisin njohuritë për përdorimin e këtyre pajisjeve dhe njohuritë për rreziqet që vijnë nga përdorimi jo i sigurt i internetit.

Përmirësimi i njohurive të fëmijëve në përdorimin e pajisjeve teknologjike krijojnë një lloj pavarësie e cila i nxitë ata për përdorim më të shpeshtë të internetit. Me këtë rriten edhe gjasat që fëmijët të jenë të nxitur në zbulimin dhe gjetjen e mjeteve dhe mënyrave për qasje në faqe të internetit që



kanë përmbajtje të pa përshtatshme për moshën e tyre.

Rreziqet për fëmijët gjatë përdorimit të internetit mund të jenë të shumta, varësisht nga mosha, faza e zhvillimit mënyra se si lidhen në internet. Në kohën në të cilën po jetojmë, çdo fëmijë është vetëm një klik larg nga pornografia e turpshme, keqbërësit/grabitqarët, dhe kërcënimet e ndryshme që gjithashtu janë duke u përhapur shumë në botën e internetit. Asnjë fëmijë nuk është imun ndaj këtyre rreziqeve në internet dhe prindërit dhe edukatorët bartin një përgjegjësi të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve. Ata duhet të

jenë në vijë të parë të mbrojtjes kundër rreziqeve online.

Në vijim do përmendim disa nga rreziqet më të shpeshta, mirëpo nuk përjashtohen edhe rreziqet të tjera që nuk janë përfshirë në këtë vëllim. Këto janë: sajberdhuna, takimi me njerëz të panjohur, ekspozimi ndaj përmbajtjes pornografike, lojërat online, si dhe keqpërdorimi i të dhënave personale. Në vijim do të elaborojmë rreziqet kryesore më të shpeshta që fëmijët hasin gjatë përdorimit të internetit dhe do të ofrojmë zgjidhje për raste të caktuara.

SAJBËRDHUNA



Sajberdhuna është përdorimi i qëllimshëm dhe i përsëritur i mjeteve elektronike dhe internetit nga fëmijët dhe adoleshentet për të ngacmuar, kërcënuar, munduar, poshtëruar, turpëruar apo përdorimi i ndonjë forme tjetër e të dhunës ndaj një fëmije apo adoleshenti tjetër.

'Cyber bullying' është terminologji në gjuhën angleze që përdoret kur njerëzit përdorin internetin për të kërcënuar, ngacmuar apo poshtëruar dikë duke dërguar mesazhe të këqija, fotografi dhe video tronditëse të personat e panjohur. Ka disa forma të sajberdhunës, mirëpo këto janë më të shpeshtat:

- Dërgimi i e-mailave apo mesazheve që mund të jenë kërcënuese apo shqetësuese (psh. mesazhe fyese, raciste apo paragjykime të tjera apo fyerja e fëmijëve duke ju vënë nofka apo pseudonime);
- Dërgimi ose postimi i thashethemeve të shokët apo direkt të viktimeve;
- Postimet në rrjetet sociale — psh. i sekreteve të dikujt në rrjetet sociale;
- Dërgimi ose postimi i fotografive të personave të tjerë, pa lejen e tyre (zakonisht fotografi turpëruese ose intime/personale) në internet;
- Krijimi i profileve apo uebfaqeve të caktuara në internet, duke shënjestruar një individ apo

grup të caktuar fëmijësh me qëllim talljeje apo fyerjeje.

Fëmijët përdorin metoda dhe teknologji të ndryshme për të ushtruar sajberdhunë, mirëpo më të shpeshtat janë telefonatat, mesazhet përmes telefonit, e-mailat apo mesazhet në rrjetet sociale, fotografitë digjitale (nga aparatet digjitale dhe telefonat mobil), lojërat online, etj. Në rast se jeni në dijeni që fëmija ka pranuar mesazhe të sajberdhunës, atëherë është mirë që të mësoni fëmijët se si t'i raportojnë ato. Preferohet që mesazhet e tilla të ruhen si dëshmi për raportim eventual në polici apo shkollë (varësisht nga rrezikshmëria e mesazheve).

SI TË DALLONI NËSE FËMIJA ËSHTË DUKE PËRJETUAR SAJBËRDHUNË?

Fëmijët të cilët ngacmohen online kanë pak a shumë të njëjtat simptome apo mënyra të përballjes me problemet me të cilat ata ballafaqohen. Ju rekomandojmë që nëse vëreni disa nga sjelljet e mëposhtme tek fëmija juaj, të konsultoheni me të dhe të diskutoni problemet. Fëmijët që janë viktime të sajberdhunës zakonisht:

- Ndihen të frikësuar, shqetësuar, pikëlluar, apo frustruar sa herë që përdorin internetin,
- Kanë doza të depresionit,

- Lëshojnë mësimet,
- Kalojnë shumë më pak kohë me shoqërinë,
- Fshehin aktivitetet e tyre online,
- Flasin në telefon më privatisht dhe shkëmbejnë mesazhe shpesh,
- Flasin me ju për fëmijë të tjerë që janë viktime të sajberdhunës,
- Nuk bëjnë gjumë të rregullt dhe i çrregullohet bioritmi.

PASOJAT E SAJBËRDHUNËS

Viktimat e sajberdhunës pësojnë të njëjtat efekte negative sikurse ngacmimi në jetën e përditshme, por shpesh efektet e sajberdhunës janë më të mëdha për shkak se mesazhet mund të bëhen publike dhe mund të shihen nga një audiencë e madhe e pa kufi.

Rreziku më i madh vjen nga fakti se ky abuzim i filluar nëpërmjet internetit, shpesh nuk ndalet

me aq, mirëpo mund të vazhdojë t'i ndjek fëmijët edhe në jetën e përditshme duke i shqetësuar ata gjatë aktiviteteve ditore e duke ndikuar në jetën normale të tyre. Gjithashtu për shkak që interneti mundëson ruajtjen e informatave për kohë shumë të gjatë, mesazhet fyese ndaj fëmijëve mund të ruhen dhe t'i shqetësojnë fëmijët deri në moshë të rritur.

ÇFARË DUHET TË BËJNË PRINDËRIT DHE EDUKATORËT KUR MËSOJNË QË FËMIJA PO PËRBALLET ME SAJBËRDHUNË?

Prindërit dhe edukatorët duhet të jenë gjithmonë në dispozicion të fëmijës nëse ata i kanë informuar që janë viktima të sajberdhunës. Por edhe nëse ju dyshoni që fëmija juaj është viktimë e sajberdhunës (sepse ka shumë indikatorë nga lista më lartë) ju mund t'i ndihmoni ata duke biseduar me ta apo duke shikuar historinë e kontakteve të tyre.

Nëse fëmija është viktimë e sajberdhunës ju duhet që së pari të kuptoni shkallën e shqetësimit tek fëmija. Sajberdhunë është dërgimi i SMS-ve ngacmues nga numra të panjohur tek fëmija por edhe përhapja e fotove apo videove me përmbajtje erotike të fëmijëve nëpër rrjete sociale. Prandaj është me rëndësi që të kuptoni shkallën e

rrethikshmërisë, sepse sa më e madhe të jetë ajo, sa më të ndryshme janë mënyrat e përbaljes.

1. Flisni me fëmijën dhe sigurohuni që ai/ ajo të ndihet i sigurt:

Në të gjitha rastet e sajberdhunës, pikë së pari, ne rekomandojmë që ju të flisni me fëmijën. Kjo do të ndihmojë fëmijën në aspektin psikik që të kuptojë se pa marrë parasysh rreziqet ata janë të mbrojtur nga prindi apo edukatori.

2. Flisni me shokët/shoqet e tyre

– Kjo është mënyrë e mirë për të marrë disa perspektiva tjera për ndodhitë. Zakonisht fëmijët i ndajnë këto përvoja me shoqërinë e ngushtë më

shumë se me ju dhe rrjedhimisht ata mund të dinë më shumë se ju.

3. Identifikojeni sajërdhunesin dhe arsyen e konfliktit

– Kur të zbuloni sajërdhunesin ju mund të kontaktoni atë dhe të informoni ata se fëmija është i mbrojtur dhe rasti mund të denoncohet në polici.

4. Ruani të gjitha dëshmitë e sajërdhunës

– Ju mund të ruani të gjitha mesazhet kërcënuese dhe shqetësuese në një folder të veçantë dhe mesazhet e reja nga ata përdorues të ruhen automatikisht në këtë folder. Ruajtja e mesazheve ju shërben në rast se në të ardhmen ju duhen prova kundër sajërdhunesit.

5. Raportoni mesazhet e rrezikshme

në uebfaqet e rrjeteve sociale përmes opsioneve përkatëse apo drejtpërdrejt tek administratori i uebfaqeve. Kjo do të ju ndihmojë administratorëve që të bllokojnë përdorues të rrezikshëm.

6. Nëse shkalla e rrezikshmërisë është e lartë atëherë ju duhet të lajmëroni policinë

– Ekziston drejtori e veçantë në polici që merret me krimet kibernetike dhe dikush nga kjo njësi mund të ju ndihmojë që të ndjekin penalisht keqbërësit.



Takimi me njerëz të panjohur

Shqetësimi kryesor i prindërve dhe edukatorëve sa i përket sigurisë së fëmijëve në internet është takimi me njerëz të panjohur të cilët i kanë njoftuar përmes internetit. Ky shqetësim është shumë i arsyeshëm pasi që po jetojmë në një kohë kur qasja në internet dhe përdorimi i pakontrolluar i rrjeteve sociale ka bërë që fëmijët të jenë shumë të ekspozuar ndaj rreziqeve që vijnë nga njerëz të panjohur. Fëmija mund të takohet me persona shumë të rrezikshëm të cilët kanë për qëllim që të lëndojnë fëmijën tuaj në mënyra të ndryshme. Pas

diskutimit edhe me policinë, shpesh kemi mësuar për raste kur adoleshentët kanë përfunduar si viktime të trafikimit përmes komunikimit online me njerëz të panjohur. Për shkak që fëmija juaj është naiv dhe i pambrojtur, ai/ajo mund të jetë target i shumë keqbërësve të cilët mund të i vjedhin identitetin, ta ngacmojnë, ta përcjellin dhe shqetësojnë, të vjedhin adresën e tyre, etj. Kontakti me përdorues të panjohur kryesisht bëhet përmes mesazheve nëpër rrjete sociale. Duke pas parasysh që fëmijët në Kosovë i përdorin shumë



këto rrjete dhe njohuritë e tyre për të mbrojtur të dhënat personale janë të vogla, atëherë mund të themi që fëmijët janë mjaft të rrezikuar. Rrjetet sociale ofrojnë një platformë të komunikimit që lehtë mund të keqpërdoret nga të rriturit dhe mund të nxisë apo ndihmojë keqbërësit që të ngacmojnë fëmijët duke lënë kështu pasoja serioze tek fëmijët.

Të gjeturat nga pyetësi kanë treguar se 58% e fëmijëve kanë biseduar në internet me dikë që nuk e kanë njohur personalisht më parë dhe, 69% e këtyre fëmijëve janë takuar me të panjohur nga bisedat në internet. Ky fakt tregon që takimi me njerëz të panjohur nuk është mit por realitet.

PAZOJAT E MUNDSHME NGA TAKIMI ME NJERËZ TË PANJOHUR:

- Dhuna fizike apo sajberdhuna ndaj fëmijës
- Keqpërdorimi i të dhënave personale
- Vjedhja e identitetit
- Keqtrajtimi fizik dhe kërcënim
- Dhunimi seksual apo psikologjik

Sipas të gjeturave nga raporti Siguria e Fëmijëve në internet, shumica e fëmijëve që takohen me të panjohur përmes internetit takohen me bashkëmoshatarë.

Rreziku i dëmit nga takimi me bashkëmoshatar është më i ulët se sa nga takimi me njerëz më të moshuar. Por të gjeturat nga raporti tregojnë që 10% e fëmijëve takohen me njerëz më të vjetër dhe kështu rreziku i dëmit fizik dhe psikologjik është më i madh. Për dallim nga rreziqet e tjera, takimi me njerëz të panjohur mund të jetë më i rrezikshmi dhe pasojat nga këto takime mund të rezultojnë fatale për fëmijën.

SHENJAT QË FËMIJA ËSHTË DUKE KOMUNIKUAR ME NJERËZ TË PANJOHUR ONLINE:

- Kalon shumë kohë online në rrjete sociale
- Ka foto të njerëzve të panjohur në telefon apo në kompjuter
- Fol shpesh në telefon dhe nuk tregon për identitetin e bashkëbiseduesit
- Fëmija shpejt e ndryshon ose e fik monitorin e kompjuterit, kur ju afroheni
- Ndryshimet e dukshme në sjellje, duke përfshirë edhe rritjen e fshehtësive ose vetëmbrojtjes
- Kalon më pak kohë se zakonisht me shokët apo shoqet
- Merr mail nga dikush që ju nuk e njihni
- Merr dhurata nga persona të panjohur
- Shpenzon sasi të madhe të kohës online, sidomos gjatë natës
- Bëhet më i/e tërhequr nga familja

ÇFARË DUHET TË BËJNË PRINDËRIT DHE EDUKATORËT KUR MËSOJNË QË FËMIJA PO KOMUNIKON ME TË PANJOHUR?

Prindërit dhe edukatorët duhet të jenë gjithmonë vigjilent për aktivitetet e fëmijës online. Sa më i ri në moshë që të jetë fëmiju, aq më i madh duhet të jetë kujdesi. Ne ju rekomandojmë që kohë pas kohe të lexoni komentet që fëmijët marrin në foto apo postimet e tyre në rrjetet sociale. Në këtë mënyrë ju do të mund të identifikoni edhe personat me të cilët fëmija komunikon më shpesh si dhe të kuptoni relacionet që fëmija ka me komentuesit. Në rast se shihni persona të njëjtë që nuk janë moshatarë të tyre duke i komentuar në aktivitete online, atëherë ju duhet të pyesni fëmijën për identitetin e personit në fjalë.

- Flisni me fëmijën dhe sigurohuni që ai/ajo të kuptojë rreziqet që mund të vijnë nga komunikimi me të panjohur
- Identifikojeni personin e panjohur dhe arsyen e kontaktimit
- Ruani të gjitha dëshmitë e bisedave
- Raportoni në rrjete sociale personin si person të dyshimtë

Nëse shkalla e rrezikshmërisë është më e lartë dhe mesazhet dhe takimet e fëmijës janë shqetësuese atëherë lajmëroni policinë. Një gjë e tillë gjithsesi duhet të bëhet nëse personi i panjohur është i rritur.



Ekspozimi ndaj përmbajtjes pornografike



Fëmijët lehtë mund të jenë të ekspozuar ndaj materialeve të paligjshme, shpeshherë edhe pa e kuptuar se janë të paligjshme, dhe të dëmshme për moshën e tyre. Në Kosovë kjo është shumë

e lehtë për tu bërë duke pas parasysh që në shumicën e rasteve, operatorët e faqeve të internetit nuk marrin masa efektive për të kufizuar qasjen e fëmijëve në faqet e ndaluara për këtë moshë. Për më shumë, fëmijët shpeshherë hapin llogari fiktive me qëllim të hapjes së këtyre faqeve që janë të dedikuara për të rriturit. Kjo fushë është e pa rregulluar në Kosovë dhe qasja në faqe të ndryshme të internetit e cila nuk është e lejuar për moshat e reja është fare e lehtë. Për fat të keq, shumë prindër nuk janë të informuar për t'u marrë me çështjet e sigurisë në internet dhe kanë nevojë për ndihmë të besueshme nga jashtë. Në anën tjetër, naiviteti, papërvoja dhe sinqeriteti i pastër i fëmijëve mund t'i çoj ata drejt rreziqeve online. Fëmijët mund të kenë qasje në përmbajtje pornografike rastësisht ose qëllimisht nga kurioziteti.

Nga anketa e bërë me fëmijë nga Qendra FIT, 38% e fëmijëve kanë raportuar që kanë parë imazhe me përmbajtje pornografike gjatë vitit të kaluar. Ndërsa 42% e këtyre fëmijëve kanë deklaruar që kanë qenë shumë të shqetësuar pasi që kanë parë përmbajtje të tillë online. Në anën tjetër, shumica e këtyre fëmijëve kanë përdorur telefonat dhe kompjuterët e tyre për të shikuar këto video. Shumica e fëmijëve (80%) të cilët

kanë shikuar përmbajtje pornografike e kanë bërë këtë në shtëpinë e shokut/shoqes, në dhomën e tyre të ndejës (77%), ose në dhomën e tyre të fjetjes (76%). Por vlen të theksohet se 28% e fëmijëve kanë raportuar se kanë shikuar video

me përmbajtje pornografike në shkollë. Kjo do të thotë se qasja në internet në shkolla nuk është e mbikëqyrur nga mësuesit dhe nuk ekziston bllokimi i ueb faqeve të rrezikshme apo të papërshtatshme për fëmijët nën moshën 18 vjeçare.

DISA NGA SHENJAT QË TREGOJNË SE NJË FËMIJË ËSHTË DUKE PARË PORNOGRAFI ONLINE JANË:

- Fëmija shpejt e ndryshon ose e fik monitorin e kompjuterit, kur ju afroheni
- Ndryshimet e dukshme në sjellje, duke përfshirë edhe rritjen e fshehtësive ose vetëmbrojtjes
- Ju gjeni pornografi në kompjuterin e fëmijës suaj
- Rritja e pop-ups ose e-mail-ve të papërshtatshme në kompjuterin tuaj
- Fëmija juaj është duke përdorur një llogari online që i përket dikujt tjetër
- Fëmija juaj bëhet i tërhequr nga familja
- Fëmija juaj shpenzon sasi të madhe të kohës online, sidomos gjatë natës
- Fëmija juaj merr telefonata nga njerëz të panjohur, ose bën thirrje, nganjëherë në distancë të gjatë, në numrat që ju nuk i njihni
- Fëmija juaj merr mail nga dikush që ju nuk e njihni
- Fëmija ka një kureshtje të pazakontë në lidhje me seksualitetin e moshës së tij
- Fëmija tregon shenja të parakohshme të aktivitetit seksual



PASOJAT NGA PORNOGRAFIA JANË TË SHUMTA, PORNOGRAFIA NDIKON:

- negativisht në shëndetin emocional dhe mendor të fëmijëve;
- promovon "mungesën e edukimit" seksual;
- është një falsifikues për dashuri dhe intimitet;
- mëson se "argëtimi i të rriturve" është normal dhe i dëshirueshëm;
- bën të pandjeshëm shikuesit dhe rrit një oreks për llojet më të devijuara, të çuditshme, ose të dhunshme të pornografisë;
- ruan imazhet që nuk mund të fshihen asnjëherë;
- ndihmon agresionin seksual;
- mund të çojë në mishërim (adhurim obsesiv ndaj pjesëve të trupit dhe vlerësimit të femrave nga madhësia dhe forma e këtyre pjesëve);
- mund të çojë në rritjen e egërsisë seksuale ndaj femrave; dhe
- mund të shkaktojë ose nxisë përdhunimin, i cili si është një vepër penale.

Roli i prindit dhe edukatorit në rastet e tilla, dhe jo vetëm, është që të angazhohen në ngritjen e vetëdijesimit për të edukuar fëmijët që të përdorin internetin në mënyrë të përgjegjshme. Prindërit dhe edukatorët duhet të bisedojnë më fëmijët për aktivitetet e tyre, të shfletojnë së bashku faqet e internetit dhe të diskutojnë për masat e sigurisë. Me fëmijët duhet të bisedohet për tema që kanë të bëjnë me seksin në përgjithësi në mënyrë që të evitohen efektet e dëmshme të pornografisë. Nëse prindërit dhe edukatorët e kanë të vështirë të flasin me fëmijët dhe nuk e bëjnë këtë, atëherë gjasat për rritjen e efekteve të dëmshme rriten.

ÇFARË DUHET TË BËJMË PRINDËRIT DHE EDUKATORËT KUR FËMIJA HASË PORNOGRAFI NË INTERNET?

Së pari prindërit dhe edukatorët duhet të përpiqen të:

- Kuptojnë se fëmijët natyrshëm janë kurioz për seksin;
- Kuptojnë se fëmijët duhet dhe duan udhëzime nga të rriturit;
- Edukojnë fëmijët rreth seksualitetit të shëndoshë, respektit për veten e tyre dhe seksin e kundërt;

- Ndhimojnë fëmijët të zëvendësojnë mesazhet e falsifikuara me mesazhet të vlerave të shëndetshme seksuale;
- Mbjajnë linjat e komunikimit të hapur duke dëgjuar se çfarë thonë fëmijët dhe çfarë mbajnë fshehtas e nuk e thonë.

Gjithashtu prindërit duhet të pyesin fëmijët:

- nëse ata kanë parë ndonjëherë në internet diçka që i ka vënë në siklet ose i ka bërë kurioz?
- Nëse ata kanë parë aksidentalisht foto seksuale online?
- Si ka ndodhë kjo? Çfarë kanë bërë? Si janë ndjerë?
- Nëse ndonjëri nga shokët e tyre ka pasur qasje në pornografi ndonjëherë? Aksidentalisht apo me qëllim?

A duhet të kërkoj ndihmë për fëmijën tim? Nëse mendoni se fëmija juaj ka qenë i ekspozuar ndaj pornografisë në internet, do të jetë e natyrshme për ju si një prind të pyesni veten nëse ju duhet të kërkonj ndihmë profesionale për fëmijën tuaj. Fillimisht, do të jetë e rëndësishme për të përcaktuar ashpërsinë e përmbajtjes pornografike që fëmija juaj ka shikuar. Çfarë fotografi të kufizuara të pjesëve të veçanta të trupit? A kanë përfshirë ato akte seksuale, dhunë, apo brutalitet?

Fëmija më vonë a është përpjekur të imitojë aspektet që ka parë ndaj një fëmije tjetër?

Shpesh, vendimi për të kërkuar ndihmë profesionale nga ndonjë ekspert është bërë rast pas rasti dhe varet edhe nga mosha e fëmijës. Për shembull, nëse fëmija juaj adoleshent rastësisht kishte hasur në imazhe pornografike dhe të ka bërë një diskutim të hapur për atë që ka parë me ju, atëherë ju nuk keni nevojë të kërkonj ndihmë për fëmijën tuaj. Megjithatë, në qoftë se një fëmijë është i traumatizuar qartë nga imazhet e shikuara në internet, rregullisht shikon pornografi, ose më vonë vepron jashtë kundrejt një fëmije tjetër, ju do të duhet të merrni në konsideratë ndihmën e një psikologu profesional. Mënyrë e mirë mund të jetë edhe diskutimi me psikologun e shkollës.

Nuk është poenta për të reaguar apo turpëruar fëmijën tuaj, por për të krijuar një mjedis të hapur dhe të dashur, ku ju dhe fëmija juaj mund të diskutoni hapur për atë se çfarë ka parë. Pastaj, ju do të jeni në gjendje për të përcaktuar rrjedhën e duhur të veprimit. Pavarësisht nga ajo që është parë, qëllimi është të ndihmoni në shërimin e fëmijës tuaj dhe të lehtësoni çdo vuajtje që ai ose ajo mund të ketë përjetuar – jo për të ndëshkuar fëmijën tuaj.

Pasionimi pas video-lojërave

Sot, koncepti i lojërave ka ndryshuar rrënjësisht. Derisa prindërit e fëmijëve të sotshëm fëmijërinë e kanë kaluar duke luajtur me moshatarët e tyre, pranë shtëpisë apo në park sot, fatkeqësisht, fëmijët kohën e lirë e kalojnë kryesisht para ekranit qoftë të televizorit, kompjuterit, iPad apo telefonit celular. Me zhvillimin dhe avancimin e teknologjisë dhe sidomos me futjen e internetit në gati secilën shtëpi, edhe mënyra e lojës ka ndryshuar nga ajo reale në atë virtuale. Në ditët e sotme, fëmijët mund të luajnë video lojëra në kohë reale me lojtarë nga mbarë bota përmes një faqeje të internetit. Bota e lojërave online po

zgjerohet me shpejtësi dhe me këtë po rriten edhe rreziqet nga këto lojëra.

Në Kosovë, kycja në lojëra të ndryshme online jo vetëm që nuk është e kufizuar por edhe janë bërë investime të shumta me dyqane për lojëra online dhe qasja në lojëra nuk është e kufizuar nga operatorët që ofrojnë internet në Kosovë. Në Kosovë ka nevojë që të merren masa efektive për të kufizuar qasjen e fëmijëve në faqet e lojërave që nuk janë të pranueshme për moshat e caktuara. Varësia nga lojërat mund të ketë pasoja të rënda fizike, emocionale dhe sociale.



PASOJAT NGA LOJËRAT E DHUNSHME ONLINE:

- Lojërat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin emocional dhe mendor të fëmijëve;
- Përdorimi i tepruar i internetit ndikon negativisht në shëndetin dhe zhvillimin social të fëmijut. Qëndrimi i gjatë para kompjuterit pa biseduar me ndokënd tjetër ndikon që fëmijët të bëhen më të mbyllur, të mos përmirësojnë aftësi sociale të komunikimit; të humbin ndjenjën e komunitetit dhe të bëhen të izoluar;
- Disa video lojëra ndikojnë që fëmijët të bëhen agresivë në sjellje ose në mendime;
- Fëmija bëhet pasiv dhe mund të ketë probleme me mbipeshën;
- Studiues të ndryshëm kanë gjetur se ka një korrelacion ndërmjet depresionit dhe luajtjes së lojërave të dhunshme kompjuterike;
- Fëmijët që luajnë video-lojëra shpesh bëhen të dhënë pas lojërave.

Nëse dyshoni që fëmija juaj është i dhënë pas lojërave online dhe kjo paraqet një rrezik sepse ai nuk ka mundësi të kontrolloi sjelljet e tij dhe gjithashtu mund të ketë efekte të tjera shëndetësore, atëherë vërtetoni nëse fëmija juaj ka dy ose tre nga këto simptome (shenja) kryesore.



SHENJAT QË FËMIJA ËSHTË DUKE KALUAR MË SHUMË KOHË SESA QË DUHET DUKË LUAJTUR LOJËRA ONLINE:

- Preokupimi pas kompjuterit ose pajisjeve të ngjashme elektronike;
- Minimizimi i shpejtë i përdorimit të kompjuterit;
- Shfaqja e mungesës së kontrollës;
- Humbja e kohës;
- Rezultate të dobëta në shkollë;
- Shfaqja e impakteve negative në fushat e tjera të jetës;
- Tërheqja (mbajtja në distancë);
- Keqpërdorimi i parave;
- Shfaqje ndjenja të përziera.

ÇFARË DUHET TË BËJNË PRINDËRIT DHE EDUKATORËT KUR FËMIJA ËSHTË I DHËNË PAS VIDEO-LOJËRAVE NË INTERNET?

- Nëse fëmija shpenzon shumë kohë duke luajtur video lojëra në kompjuter, përpiquni të i gjeni gjëra të tjera për të bërë kur ai është në shtëpi.
- Nëse ai është kreativ ose ka ndonjë talent, ndihmoni atij që të zhvilloi atë talent; Për shembull, nëse dëshiron të merret me ndonjë sport, regjistrojeni në ndonjë klub.
- Udhëzojeni të rregulloi ose dekoroi dhomën e tij ose kërkoni nga ai ndihmë për ndonjë projekt tuajin, mirëpo mos kërkoni nga ai që ti shtoni obligimet rreth punëve të shtëpisë, sepse ai do të ndihet si kur është i dënuar dhe kjo nuk ndihmon.
- Bisedojnë me fëmijën dhe të vendosin disa rregulla për të dal nga ajo situatë;
- Kërkoni ndihmë profesionale për fëmijën tuaj nga ndonjë profesionist që ka përvojë për tu përballur me fëmijë të pasionuar pas video-lojërave.



Publikimi dhe keqpërdorimi i të dhënave personale

Ka shumë mënyra që rrisin ekspozimin e fëmijëve ndaj rreziqeve në internet, dhe njëri nga këta faktorë është publikimi i të dhënave personale të fëmijëve. Mos kontrollimi i parametrave të privatësisë nëpër rrjete sociale apo adresa elektronike është shumë i rrezikshëm pasi që persona të dytë mund të keqpërdorin të dhënat personale të fëmijëve.

Çfarë janë të dhënat personale? - Të gjitha informacionet që mund të identifikojnë personalitetin e fëmijës paraqesin të dhëna personale. Emri, mbiemri, fotografia nga e cila ti mund të identifikohen, datëlindja, adresa,

profesioni, numri i telefonit, IP adresa e kompjuterit, janë të gjitha të dhëna personale.

Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale -

Mbrojtja e të dhënave personale është e drejtë fundamentale e garantuar me Kushtetutë neni 36 dhe rregulluar edhe me Ligjin 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ky ligj ka për qëllim që ti të jesh i sigurt se të dhënat tuaja personale shfrytëzohen në mënyrë të drejtë dhe nuk keqpërdoren. Njëherit, mbrojtja e të drejtës në privatësi është e garantuar me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mbrojtja e të dhënave personale është pjesë e së drejtës në




privatësi, si një nga të drejtat dhe liritë elementare të njeriut.

Publikimi i të dhënave personale siç janë emri dhe mbiemri, emri i shkollës, numri i telefonit, email adresa, adresa e shtëpisë nuk rekomandohet për fëmijë. Rreziqet nga takimet me të panjohur mund të rriten shumë më shumë nëse fëmija publikon të dhëna personale në internet përmes rrjeteve

sociale. Rezultatet nga pyetësi me fëmijë që shumica e fëmijëve kosovar postojnë fotografitë e tyre personale (92%), emrin e shkollës (67%), email adresën (33%), adresën e shtëpisë (15%) dhe numrin e telefonit (12%) në rrjetet sociale. Publikimi i këtyre të dhënave paraqet një rrezik të madh për fëmijët pasi që lehtëson shumë kontaktin personal me të panjohurit.

SI FUNKSIONON KY RRJET I INFORMATAVE?



SI TË KËRKOJMË FSHIRJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË FËMIJËVE?

- Duke kontaktuar personin i cili ka bërë publikimin e të dhënave personale nga i cili kërkoni që të bëjë fshirjen e tyre;
- Ju mund të kërkoni nga ofruesi i shërbimit të internetit (anglisht internet provider) që të bëjë fshirjen e të dhënave tuaja personale;
- Kontaktoni Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës.
- Gjatë regjistrimit apo plotësimit të formularëve të ndryshëm, të japin vetëm informatat e kërkuara që janë të shënuara me shenjën e yllit (*);
- Vërtetoni se një faqe interneti është e sigurt duke kërkuar shenjat identifikuese.

SI TË VËRENI NËSE TË DHËNAT E FËMIJËS JANË NË RREZIK APO PO KEQPËRDOREN?

- Pranoni emaile nga fëmija me reklama apo virus të ndryshëm;
- Pranoni ftesa nëpër rrjete sociale për të klikuar në faqe të ndryshme;
- Kompjuteri që e përdor fëmija ka vazhdimisht virus të ndryshëm;
- Shihni postimi që nuk janë të fëmijës por kanë identitetin e tyre.

KËSHILLA QË MUND TË JU OFRONI FËMIJËVE TUAJ PËR MBROJTJE MË TË MIRË:

- Ata duhet të lexojnë me kujdes politikat e privatësisë për faqet e internetit të cilat i përdorin;
- Inkurajoni që të publikojnë sa më pak detaje që i identifikojnë ata apo vendndodhjen e tyre;
- Të mos publikojnë online gjëra të cilat nuk dëshironi të jenë publike;
- Të mos e ndajnë e-mail adresën private me njerëz që nuk i njohin dhe të mbajnë vetëm për vete fjalëkalimin;
- Gjatë regjistrimit apo plotësimit të formularëve të ndryshëm, të japin vetëm informatat e kërkuara që janë të shënuara me shenjën e yllit (*);
- Vërtetoni se një faqe interneti është e sigurt duke kërkuar shenjat identifikuese.

ÇKA JANË VIRUSET NË KOMPJUTER?

Viruset janë programe softuerike të dizajnuar që qëllimisht të ndërhyjnë në operacionet kompjuterike, të korruptojnë të dhënat, ti fshijnë të dhënat, apo të shpërndahen në kompjuterë

tjerë përmes internetit. Në këtë mënyrë viruset ndikojnë në sigurinë dhe privatësinë e fëmijëve në internet.





Informata të përgjithshme për të dhënat personale për prindër

Të dhënat personale të fëmijëve tuaj nuk mund të shfrytëzohen nga të tjerët pa pëlqimin tuaj. Ti mund të japësh pëlqimin tënd në mënyrë vullnetare dhe këtë pëlqim ke të drejtë ta tërheqësh në çdo kohë. Është e drejtë e juaja të kërkonit nga të tjerët që mos të postojnë informata ose foto të fëmijëve tuaj në blogjet dhe faqet e rrjeteve sociale pa lejen tuaj.

Ti ke të drejtë të jesh i/e informuar se çfarë të dhënash personale ruajnë të tjerët për fëmijën, për çka do t'i shfrytëzojnë dhe në çfarë mënyre kanë ardhur deri te të dhënat personale. Ti gjithmonë ke

të drejtë të kërkohësh që të dhënat e fëmijës që nuk janë të sakta dhe të kompletuara të korrigjohen.

Nëpërmjet motorëve të kërkimit (p.sh. Google, Yahoo) kërkonit emrin e fëmijës tuaj për tekst dhe foto. Nëse në një faqe interneti gjeni informata të ndjeshme për fëmijën tuaj, drejtohuni kësaj faqe me një kërkesë për të hequr informacionet nga kjo faqe. Për të dhënat personale të ndjeshme (të dhënat që zbulojnë origjinën etnike ose racore, përkatësinë fetare, jetën seksuale, shëndetin, veprimet penale) çdoherë duhet të kërkohet pëlqimi me shkrim.

KËSHILLA TË PËRGJITHSHME PËR PRINDËR

Kjo pjesë e Udhëzuesit ka për qëllim të ju ofrojë këshilla të përgjithshme prindërve se si ata duhet t'i mësojnë fëmijët për t'u mbrojtur gjatë përdorimit të internetit.

1. Mbjani kompjuterin në dhomën tuaj të ndejës



- Mbani kompjuterin në dhomën e ndejës dhe poziciononi monitorin e kompjuterit në atë mënyrë që të gjithë të kenë mundësi të shohin monitorin gjatë përdorimit të internetit. Sidoqoftë, në familje ku përdoren më shumë se një pajisje që kanë mundësi për lidhje në internet të kihet kujdes, sepse këmbëngulja e prindërve se të gjithë duhet të përdorin internetin në të njëjtën dhomë dhe në të njëjtën kohë mund të shkaktojë pakënaqësi.
- Mundohuni të jeni sa më shumë të pranishëm në momentet kur fëmijët janë duke përdorur

internetin, ose konsideroni përdorimin e programeve për monitorim siç është "parental control".

- Kujdes, sa më shumë që rriten fëmijët ata kërkojnë më shumë privatësi gjatë përdorimit të internetit. Këtë e arrijnë shpesh duke përdorur Laptop, apo pajisje tjera teknologjike dhe rrjetin wireless. Në këtë rast është mjaft e vështirë për t'i monitoruar fëmijët gjatë përdorimit të internetit.

2. Instalo dhe azhurno antivirusin dhe programet mbrojtëse



- Sigurohu se kompjuteri i juaj ka të instaluar program mbrojtës (-firewall) e antivirus dhe se ky program është funksional dhe i azhurnuar.
- Instalo dhe azhurno antivirusin dhe programet mbrojtëse.

3. Fillo të bisedosh sa më herët me fëmijët tuaj

- Përdor kontaktet e përditshme me fëmijët për të biseduar lidhur me përdorimin e internetit. Mos prisni që ata të –fillojnë bisedën edhe nëse ju jeni shumë të afërt në komunikim me fëmijët tuaj.
- Sapo fëmija juaj fiton të përdorë kompjuterin, telefonin celular ose ndonjë pajisje tjetër për të u kyçur në internet, prindërit duhet të bisedojnë me fëmijët e tyre se si ata duhet të sillen dhe të komunikojnë në internet .
- Ju si prind, duhet të bisedoni me fëmijën tuaj lidhur me sigurinë në internet para se këtë ta bëjë dikush tjetër.



4. Krijoni një ambient të hapur dhe të përshtatshëm për bisedë me fëmijët

- Fëmijët çdo herë përrisin ndihmë nga prindërit e tyre. Prandaj, bëhu mbështetës dhe pozitiv në këtë drejtim. Dëgjoni me vëmendje dhe durim kur ata flasin dhe keni parasysh ndjenjat e tyre.

- Bëhu i durueshëm. Shumica e fëmijëve kanë nevojë t'i dëgjojnë informatat apo këshillat tuaja disa herë. Komunikimi i hapur me fëmijët tuaj është mjaft i rëndësishëm, prandaj angazhohu shumë për ta mbajtur atë. Mos reagoni vrazhdë kur fëmijët tuaj ndajnë përvojën e tyre me ju e sidomos nëse kuptoni se fëmija juaj ka bërë diçka të papërshtatshme gjatë përdorimit të internetit.
- Rregullisht bisedoni me fëmijët tuaj se si ata e përdorin internetin dhe me kë komunikojnë në internetin.
- Inkurajoni fëmijët tuaj që të ju tregojnë nëse diçka që hasin në internet i bën ata të ndjehen të kërcënuar ose të shqetësuar.
- Mësoni fëmijët tuaj se njerëzit gjatë komunikimit në internet, shpesh nuk janë në të vërtetë ata të cilët thonë se janë. Keqbindësit shpesh përdorin komunikimin në "chat" për të kontaktuar fëmijët dhe në shumë raste ata fshehën pas pseudonimeve të ndryshme.
- Falëndero fëmijët tuaj për besimin që kanë ndaj teje dhe bindi ata se duhet të raportojnë abuzuesit.

5. Krijoni rregullat e përdorimit të internetit dhe të telefonit mobil

Komunikoni, krijoni dhe pajtoheni për një listë të rregullave për përdorim të internetit dhe telefonit. Lista e rregullave duhet të përmbajë rregullat se si dhe kur fëmijët mund ta

përdorin internetin dhe telefonin. Disa nga rregullat mund të jenë temat si në vijim:

- Gjatë krijimit të listës me rregullat, kushtoji vëmendje të veçantë privatisë, moshës dhe faqeve të internetit me përmbajtje të papërshtatshme për fëmijët.
- nëse fëmijët tuaj duhet apo nuk duhet të qasen në internet;
- sa shpesh mund ta përdorin atë;
- çfarë materialesh mund të shkarkojnë;
- si të sillen kur hasin në gjëra të papërshtatshme;
- sa mund të shpenzojnë në telefon;
- kohën kur munden të përdorin internetin në telefon (p.sh. jo natën vonë).



6. Familjarizohu me faqet e internetit të përdorura nga fëmijët tuaj



- Vlerësoni faqet e internetit të cilat fëmijët tuaj i vizitojnë dhe lexoni me kujdes: rregullat e privatisë, kushtet e përdorimit dhe kodet e sjelljes. Gjithashtu, hulumto nëse faqja e internetit monitoron përmbajtjen e postuar.
- Familjarizohuni me atë se çfarë bëjnë fëmijët tuaj në internet dhe kontrollo periodikisht faqet që fëmijët tuaj i vizitojnë.
- Kupto se si fëmijët i përdorin pajisjet personale (telefonat mobil, video lojërat, dhe pajisjet tjera) për t'u lidhur në internet. Çështja e sigurisë së përdorimit të këtyre pajisjeve duhet të trajtohet ngjashëm sikur lidhja përmes kompjuterit të zakonshëm.
- Prindërit duhet të dinë se si dhe për çfarë shërbejnë këto pajisje personale.

7. Rishikimi i karakteristikave të faqeve të internetit



- Sigurohu nëse fi-ltrimi, bllokimi dhe programet monitoruese janë të mjaftueshme për përdorim të sigurt të internetit.
- Rekomandohet që prindërit të diskutojnë me fëmijët lidhur me arsyet dhe nevojën e përdorimit të programeve monitoruese dhe mbajtjes së fshehtë të fjalëkalimit të këtij programi.
- Kontrolloni nëse keni mundësi të fshini apo ndryshoni llogarinë tuaj në faqet e internetit. Nëse kjo gjë nuk është e mundur, atëherë kërkoni nga fëmijët tuaj që të mos e përdorin atë faqe ose bllokoje qasjen në atë faqe.
- Monitoro reklamat të cilat janë të papërshtatshme për fëmijët, sepse ato mund të nxisin fëmijët që të kontaktojnë me njerëz të panjohur, të qasen në fajlla të rrezikshëm,

të bëjnë sajberdhunë, apo ndonjë fenomene tjetër të ngjashëm me këto që u përmendën.

- Mbani kartelat bankare të sigurta dhe mos zbuloni fjalëkalimin (PIN) e këtyre kartelave. Keni parasysh se kur fëmijët fit-llojnë të blejnë në internet, gjasat rriten që ata të përdorin këto kartela pa pëlqimin e prindërve.
- Sigurohu se bëhet verifikimi i moshës kur blihet ndonjë artikull apo shërbime nëpërmjet internetit.

8. Edukimi i fëmijëve



- Shpjegoju fëmijëve tuaj disa nga rregullat dhe udhëzimet më elementare lidhur me përdorimin e internetit.
- Është me rëndësi që fëmijët t'u përmbahen këtyre udhëzimeve dhe t'i ndajnë ato edhe me të tjerët.
- Eduko fëmijët tuaj që të mos përgjigjen në mesazhe të vrazhda dhe t'u shmangen bisedave online rreth çështjeve seksuale.

- Mësoni fëmijët tuaj që të mos hapin 'attachment'-e ose linqe të faqeve të internetit që mund të shfaqen gjatë bisedave në chat apo kur pranojnë ndonjë e-mail prej personave të panjohur.
- Shpjegoju fëmijëve që asnjëherë të mos takohen me persona të panjohur, të cilët për herë të parë i kanë njohur vetëm në internet.
- Inkurajoni fëmijët që të përdorin faqet e internetit vetëm për të komunikuar me miqtë e tyre dhe jo me njerëz të panjohur.
- Tregojtu fëmijëve se njerëzit online mund të mos jenë ata që thonë se janë.
- Nëse fëmija dëshiron patjetër që të takojë personin që e ka njohur vetëm në internet, atëherë prindi apo ndonjë i afërm i tij i moshës së rritur duhet ta shoqërojë fëmijën në atë takim. Sigurohu që takimi i parë të bëhet në një vend publik ku ka shumë njerëz të tjerë.
- Vetëdijesoni fëmijët tuaj që të mos shpërndajnë të dhënat e tyre identifikuese personale. Ata duhet të kuptojnë se cilat informata duhet të mbahen private dhe jo të publikohen në profil të hapur.
- Inkurajoni fëmijët tuaj që të mos postojnë informata personale të tyre apo të miqve të tyre (si psh. fotografi, numrin e telefonit mobil, adresat e shtëpisë, apo emrin e shkollës së tyre) në internet.

- Udhëzoni fëmijët tuaj që asnjëherë të mos përdorin ueb-kamerat në komunikim me persona të panjohur.
- Këshilloni ata që të mos postojnë në internet materiale pa miratimin tuaj.
- Shpjegoju fëmijëve se ajo çfarë ata shkruajnë në internet mund të lexohet nga kushdo tjetër.
- Informoj fëmijët se keqpërdoruesit apo ngacmuesit shpesh kërkojnë fëmijë, të cilët janë të interesuar për të njohur miq të rinj në internet.

9. Shqyrtimi i përdorimit të sigurt të faqeve të internetit



- Kontrolllo rregullisht profi-lin e fëmijës tuaj.
- Shiko historinë e llogarisë së tij dhe, nëse është e nevojshme, ndrysho mënyrën e përdorimit të profi-lit të tij në një nivel që ju të ndjeheni rehat.

- Faqet e internetit, që janë të dizajnuara mirë, ofrojnë mundësi për prindërit që ata vetë të vendosin “parental control”.
- Ju mund të kontaktoni administratorët e faqes për të kërkuar që të fshihet ro-li i fëmijëve tuaj, nëse ata refuzojnë të respektojnë rregullat e asaj faqeje. Ky fakt gjithashtu duhet të forcojë mesazhin tuaj tek fëmijët në lidhje me rëndësinë e rregullave si dhe pasojat e mosrespektimit të këtyre rregullave.
- Sigurohu se fëmija juaj respekton ku-fizimet e moshës që bëjnë faqet e internetit. Nëse fëmijët janë më të rinj se sa moshë e rekomanduar për përdorimin e këtyre faqeve, ata nuk duhet t'i përdorin këto faqe. Për shembull, moshë minimale e lejuar për të hapur profi-lin në rrjetet sociale siç është Facebook-u apo Twitter, është 13 vjeçare.
- Sigurohu që fëmijët nuk përdorin emrin e plotë të tyre gjatë komunikimit në internet. Kudo që të jetë e mundur ata duhet të përdorin pseudonime.
- Mos lejoni fëmijët tuaj të postojnë emrat e plotë të miqve të tyre apo çfarëdo të dhëne tjetër që mund të përdoret për të identifikuar ata, siç janë: adresa, numri i telefonit, emri i shkollës dhe informata të tjera personale identifikuese.

Konkluzione

Interneti ka transformuar jetën moderne, duke ofruar komunikim të shpejt dhe qasje të pakushtëzuar në informata dhe shërbime. Mirëpo, interneti ka krijuar gjithashtu edhe mundësi të reja për keqpërdoruesit dhe abuzuesit e fëmijëve. Prandaj, pa përdorimin e masave të duhura mbrojtëse, fëmijët mbeten të ekspozuar shumë ndaj rreziqeve të ndryshme në internet, siç janë: sajberdhuna, pornogra-fia, keqpërdorimi i të dhënave personale, lojërat agresive, apo qasja në materiale të tjera të dëmshme.

Është shumë me rëndësi që prindërit dhe edukatorët, së bashku me fëmijët, të vendosin rregulla se çka është e përshtatshme dhe e sigurt për t'u përdorur në internet dhe si fëmijët të sillen në mënyrë të përgjegjshme në internet. Duke punuar së bashku prindërit, edukatorët, dhe fëmijët, mund të për-fitojnë më shumë nga përdorimi i sigurt i internetit dhe në të njëjtën kohë të minimizojnë rreziqet që i kanosen fëmijëve.

Gjithashtu, është mjaft e rëndësishme për gjeneratat e ardhshme që të ndihen të sigurt në përdorimin e internetit, me qëllim që ata pastaj të për-tojnë nga zhvillimi dhe përparimi i tij. Kur flitet për sigurinë e fëmijëve në internet është me

rendësi të flitet hapur për rrezikun në lidhje me përdorimin e pasigurt të internetit.

Shpresojmë se ky Udhëzues do t'u ndihmojë prindërve dhe edukatorëve duke ju ofruar informata të qarta dhe gjithëpërfshirëse për sigurinë në internet me qëllim që të zvogëlohen rreziqet dhe të rriten mundësitë për të për-fituar sa më shumë nga përdorimi i internetit.



Ky udhëzues është hartuar në kuadër të projektit “Mbrotjtja e fëmijëve nga rreziqet në internet - PROCON” që financohet nga Komisioni Evropian, Zyra në Kosovë.

Projekti zbatohet nga Qendra për Arsime të Kosovës (KEC) në bashkëpunim me Këshillin Rinor Kosovë (KYC) dhe International Children Safety Service (ICSS).